




Nr. 66 prot
Dt. 12/12/2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 1 Datë 11.12.2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “BREÇANI R.O.S.P.” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 42, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, të Miratimit Paraprak për vazhdimin e procedurave nga MEI nr. 2102/4 Prot., datë 02.06.2017, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor, subjektit “BREÇANI R.O.S.P.” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor **Lumi i Gashit**, për prodhim energjie elektrike në fshatin Begaj, Njësia Administrative Tropojë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, subjektit **“BREÇANI R.O.S.P.” sh.p.k.** me administrator Z.Fatbardh BREÇANI.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, **HEC DRITA** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 50 79 17; Y - 46 95 431.4; Z - + 312 m;
Koordinatat e godinës së centralit: X - 50 80 57.4; Y - 46 93 585.1; Z - + 248.5 m;
Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 50 80 57.4; Y - 46 93 585.1; Z - + 248.5 m;
Prurja mesatare : Q mes = 2.59 m³/sek;
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 4.2 m³/sek;
Prurja ekologjike: Q ekol = 0.14 m³/sek;
Prurja që shkarkohet: Q = 4.2 m³/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Raimonda GURI



KRYETAR
Gesk MILLJA

